

**Republika e Shqipërisë**  
**Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit**

**Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet  
operacionit Govtech**

**Termet e Referencës**  
**për**  
**Ekspert Ndërkombëtar të Sigurisë Kibernetike**

Korrik 2024

**1. PËRMBAJTJA**

Gjatë 15 viteve të fundit, Qeveria e Shqipërisë (QSH) është angazhuar në reforma të rëndësishme për të modernizuar sektorin e saj publik nëpërmjet një qasjeje GovTech, duke kombinuar adoptimin e teknologjive digjitale me reformat e sektorit publik, të zbatuara me një qasje të gjithë qeverisë. Synimi i këtyre reformave ka qenë rritja e efektivitetit të administratës publike dhe ofrimi i aksesit më gjithëpërfshirës në shërbime publike me cilësi të lartë për të gjithë shqiptarët. Për këtë qëllim, në vitin 2007 u krijua Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) për të udhëhequr agjendën e digjitalizimit. Në vitin 2012 AKSHI lançoi portalin e shërbimit digjital e-Albania, i cili aktualisht mundëson aplikime online në rreth 1232 shërbime (95 për qind e të gjithë qeverisë qendrore ofron shërbime administrative). Që nga viti 2023, e-Albania ka rreth 3 milionë përdorues të regjistruar (individë dhe biznese).

Progresi i dukshëm i Shqipërisë me reformat e GovTech është njohur ndërkombëtarisht. Edicioni i vitit 2022 i BB GovTech Maturity Index (GTMI) e kategorizon Shqipërinë brenda Grupit A (më i avancuari nga katër grupet), duke reflektuar një evolucion pozitiv në krahasim me edicionin e mëparshëm ku vendi pozicionohej në Grupin B. Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimi (OECD) thekson Shqipërinë si një model pozitiv për e-qeverisjen në Ballkanin Perëndimor.

Pavarësisht progresit të Qeverisë Shqiptare me transformimin digjital, sfidat mbeten, veçanërisht nga këndvështrimi i përdoruesit. Këto lidhen me nevojën për të përmirësuar sistemet ekzistuese, aplikimin e teknologjive kufitare, përmirësimin e cilësisë dhe kohës së ofrimit të shërbimeve dhe sigurimin e aksesit të barabartë në shërbimet digjitale për të gjithë shqiptarët, duke përfshirë grupet vulnerabel si të varfërit, komunitetet rurale, invalidët dhe individët me aftësi të limituara digjitale.

Për të bërë kalimin e plotë në ofrimin e shërbimeve digjitale të përqendruara te përdoruesi, dhe për të shfrytëzuar plotësisht teknologjitë më të reja për një ndikim të prekshëm në përvojën e përdoruesit në ofrimin e shërbimeve, Qeveria e Shqipërisë vazhdon të demonstrojë një nivel të lartë angazhimi politik ndaj Transformimit Digjital. Kjo mbështetet nga një vizion afatmesëm i artikuluar qartë që përbëhet nga vizioni politik i Qeverisë Shqiptare për vitin 2030 (2021), Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2022-2030) dhe Strategjia dhe Plani i Veprimit Digjital i Shqipërisë 2022-2026.

Duke patur parasysh mbështetjen afatgjatë të Bankës Botërore (BB) ndaj Qeverisë së Shqipërisë (QSH) në ofrimin e shërbimeve dhe digjitalizim, QSH ka kërkuar mbështetjen e mëtejshme të Bankës Botërore në implementimin e agjendës së saj të transformimit digjital. Qeveria e Shqipërisë dhe Banka Botërore kanë nisur zbatimin e një programi të ri për Rezultate (PforR), i cili hyri në fuqi në korrik 2023. Programi quhet “Përmirësimi i aksesit të barabartë në shërbimet publike të standardit të lartë nëpërmjet operacionit Govtech”, dhe synimi i tij është rritja e aksesit të barabartë dhe cilësisë së shërbimeve digjitale të zgjedhura në Shqipëri. Programi synon të forcojë sistemet kombëtare për të përshpejtuar kalimin në një mënyrë plotësisht të përqendruar te përdoruesi i ofrimit të shërbimeve digjitale, për t'i mundësuar Qeverisë së Shqipërisë të shfrytëzojë risitë e reja digjitale për impakt të prekshëm dhe për ta zhvendosur Shqipërinë në një pozicion dhe renditje të avancuar të GovTech.

## **Programi e mbështet Qeverinë e Shqipërisë në arritjen e objektivave të zgjedhura nën agjendën e saj të transformimit digjital në tre Fusha të Rezultateve (FR):**

### **1. Përmirësimi i aksesit në shërbimet elektronike dhe përvojës së përdoruesit**

- 1.1. Rindërtimi i Portalit e-Albania bazuar në Aksesueshmëri dhe Përvojën e Përdoruesit (UX)
- 1.2. Sigurimi i riorganizimit të shërbimit elektronik të standardeve të larta, të personalizuar dhe pro-aktive të bazuara në ngjarje
- 1.3. Përmirësimi i shtyllës (backbone) së Shërbimeve Elektronike: e-Albania, Infrastruktura TIK e Platformës së Portës Qeveritare (Government Gateway) dhe Vazhdimësia e Biznesit

### **2. Rritja e aftësive dhe gjithë përfshirjes digjitale**

- 2.1. Përmirësimi i Aftësive Digjitale dhe Themelore.
- 2.2. Përmirësimi i Shërbimit për Klientët dhe Aksesueshmërisë

### **3. Forcimi i mundësuesve parësorë të GovTech-ut.**

- 3.1. Forcimi i GovTech i të gjithë Qeverisë: Qeverisja e të Dhënave.
- 3.2: Fuqizimi i Lehtësuesve Institucional të GovTech të të Gjithë Qeverisë

Një nga fushat e nën-Rezultateve nën FR3 është përqendruar në forcimin e GovTech të gjithë Qeverisë: Qeverisja e të Dhënave.

Ka fusha të përzgjedhura ku duhet të forcohet dhe të përafrohet më tej me praktikat më të mira të BE-së, një qasje "e të gjithë qeverisë" për qeverisjen e të dhënave. Qeveria e Shqipërisë mund të bëjë përparim të mëtijshëm në qeverisjen e saj të të dhënave për të siguruar një ofrim shërbimi digjital edhe më të sigurt, të mbrojtur, të avancuar dhe të personalizuar. Së pari, sfidat kryesore për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e të dhënave përfshijnë boshllëqe në kuadrin ligjor dhe boshllëqe në kapacitetet e institucioneve të sektorit publik për të zbatuar të gjithë hapat e nevojshëm për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e informacionit. Së dyti, ndërveprueshmëria e të dhënave ka nevojë të forcohet për të ecur drejt një "sektori publik të drejtuar nga të dhënat" i cili është gjithashtu në përputhje me standardet më të fundit të ndërveprimit të BE-së. Kjo përfshin forcimin e shtresave të ndërveprueshmërisë jo digjitale dhe digjitale, si p.sh. vendosja e standardeve të meta të dhënave për të gjithë përmbajtjen digjitale. Së treti, ka dobësi në mbledhjen e të dhënave të ofrimit të shërbimeve, analizën e të dhënave dhe përdorimin e të dhënave për të përmirësuar përgjegjshmërinë e brendshme dhe vendimmarrjen e menaxhimit. Së fundi, transparenca e të dhënave dhe përdorimi publik i të dhënave mund të rritet, ka një sasi të kufizuar të dhënash të disponueshme publikisht që ndjekin standardet e praktikave më të mira të Open Data (OD) dhe portali OD nuk është projektuar mjaftueshëm bazuar në UX.

Kjo FR mbështet Qeverinë Shqiptare në objektivat e saj të programit për: (i) forcimin e qeverisjes së të dhënave, sigurinë dhe transparencën e të dhënave; dhe (ii) adoptimin e sistemeve, kërkesave dhe proceseve inteligjente dixhitale aftësuese. Për më tepër, aspektet e këtij FR janë ndërsektoriale për aq sa mbështesin arritjen më të gjerë të rezultateve sipas FR 1 dhe 2: për shembull, shërbimet proaktive kërkojnë qeverisje të fuqishme të të dhënave.

Për të përmirësuar qeverisjen, sigurinë dhe cilësinë e të dhënave, kjo FR do të mbështesë iniciativa dhe vlerësime të ndryshme mbi një temë specifike të qeverisjes së të dhënave, relevante për axhendën e transformimit digjital në kuadër të këtij Programi.

## **2. OBJEKTIVI I DETYRËS**

Këto Terma Reference (ToR) janë për një konsulent individual (këtu e tutje, Konsulenti).

Objektivi i kësaj procedure është të kontrakttojë një Konsulent Individual i cili do të kryejë një vlerësim fillestar mbi statusin aktual të sigurisë kibernetike, si dhe mbështesë AKSHI-n me çështjet dhe detyrat e përditshme mbi sigurinë kibernetike dhe kryerja e vlerësimeve më të detajuara mbi temat specifike të sigurisë kibernetike sipas kërkesave të AKSHI.

### **3. FUSHA E PUNËS DHE DETYRAT KRYESORE**

Roli i Konsulentit është të mbështesë AKSHI-n duke kryer një vlerësim fillestar duke rishikuar dokumentacionin ekzistues të Programit: Dokumenti i Vlerësimit të Programit (PAD), Termat e Referencës për komponentët e mbështetur nga programi dhe planin e koordinimit. Gjithashtu, Konsulenti do të mbledhë të dhëna për sigurinë kibernetike nga palët e interesuara të AKSHI-t për të identifikuar të gjitha pikat hyrëse për përmirësimin e sigurisë kibernetike teknike në veçanti dhe sigurisë së informacionit në përgjithësi.

Mbështetja e AKSHI-t për çdo çështje tjetër të sigurisë kibernetike sipas kërkesave të AKSHI në formën e rekomandimeve (p.sh. për personelin, trajnimin, softuerin, harduerin dhe politikat), kryerja e analizave dhe vlerësimeve.

Konsulenti pritet të punojë ngushtë me AKSHI-n, Njësinë e Koordinimit të Programit (NJK - me qendër në AKSHI) dhe do të kryejë këto detyra gjatë angazhimit:

#### ***SITUATA E FAZËS AKTUALE***

Të mbledhë dhe analizojë informacione mbi statusin aktual të sigurisë kibernetike për komponentët e parashikuar në Program.

- Të rishikojë dokumentacionin e sigurisë kibernetike për komponentët e mbuluar nga Programi.
- Te punojë ngushtë me përfituesin për të mbledhur informacion mbi statusin aktual të sigurisë kibernetike për komponentët në Program.
- Të konsolidojë këtë informacion në vlerësimin fillestar duke ofruar një përshkrim narrativ të situatës së sigurisë kibernetike siç është dhe sfidave të mundshme të ardhshme.

#### ***FAZA E KONSULTIMIT***

Të analizojë informacionin dhe japë rekomandime mbi kërkesat aktuale dhe të perceptuara të sigurisë kibernetike për komponentët e përfshirë në FR1-3 në Program për një periudhë fillestare të planit 1-vjeçar, me mundësi zgjatjeje, sipas nevojës. Lista e detyrave përfshin, por nuk kufizohet në, sa vijon.

- Të mbështesë në zbulimin, analizimin dhe zbutjen e shfrytëzimeve dhe kompromiseve;
- Të ndihmojë në zhvillimin ose përmirësimin e planeve të reagimit ndaj incidenteve për të adresuar dhe zbutur në mënyrë efektive incidentet e sigurisë kibernetike.
- Të mbështesë zhvillimin dhe zbatimin e politikave, procedurave dhe praktikave më të mira të sigurisë kibernetike për të forcuar pozicionin e përgjithshëm të sigurisë së qeverisë.

- Të këshillojë mbi politikat, mjetet dhe pajisjet për të përmirësuar parandalimin, zbulimin dhe zgjidhjen e incidenteve;
- Të monitorojë kërcënimet dhe tendencat e reja të sigurisë kibernetike në botë dhe japë rekomandime për masat proaktive të mbrojtjes.
- Të ofrojë konsultim për kornizën normative-legjislative për sigurinë kibernetike dhe/ose udhërrëfyesin për t'u anëtarësuar në komunitetet ndërkombëtare;
- Të ofrojë këshilla dhe konsulencë në fushën e bashkëpunimit dhe diplomacisë kibernetike;
- Të kryejë trajnime për tema specifike me interes, p.sh. Advanced Persistent Threat (APT), për punonjësit e AKSHI;
- Të ofrojë mbështetje specifike në zbulimin dhe zbutjen e APT-së dhe aktorëve të kërcënimit të sponsorizuar nga shteti;
- Të ofrojë rekomandime për personelin e sigurisë kibernetike.
- Të ofrojë këshilla dhe inpute në kohë për AKSHI-n për çështje të tjera të identifikuar dhe urgjente të sigurisë kibernetike, sipas nevojës.

#### **4. PRODUKTET KRYESORE**

Konsulenti do të jetë përgjegjës për produktet kryesore të mëposhtme:

##### *1. Raporti fillestar i vlerësimit*

Vlerësimi fillestar për të identifikuar situatën aktuale të sigurisë kibernetike për komponentët në Program dhe fusha të tjera (siç janë identifikuar nga AKSHI), duke përshkruar statusin aktual teknik të sigurisë kibernetike, sfidat dhe masat e rekomanduara.

Vlerësimi fillestar do të përfshijë një analizë të boshllëkut midis konfigurimit aktual teknik të sigurisë kibernetike dhe praktikave më të mira ndërkombëtare dhe një grup rekomandimesh për t'u përafuar me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Të gjitha rezultatet do të dokumentohen në një raport informativ.

Raporti i vlerësimit fillestar do të dorëzohet 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës.

##### *2. Faza e konsulencës*

Mbështetja e listës së detyrave të mësipërme duke bërë vlerësime për sigurinë kibernetike, në formën e analizës së mangësive dhe këshillave të konsulentit, me kërkesë të AKSHI;

Shënim:

- Të gjitha të drejtat e autorit dhe licencat në lidhje me produktet do t'i kalojnë AKSHI-t;
- Datat përfundimtare për aktivitetet dhe dorëzimet do të përcaktohen në marrëveshje me NjK;
- Të gjitha produktet me shkrim do të dorëzohen në gjuhën angleze. Kosto shtesë përkthimi mund të sigurohen nëse kërkohet.

## **5. RAPORTIMI**

Konsulenti do të raportojë pranë AKSHI-t dhe do të bashkërendojë nga afër aktivitetet e tij me NJK-në.

Të gjitha draftet e raporteve dhe produktet do të shqyrtohen nga AKSHI dhe palët e tjera të interesuara për t'u siguruar që gjetjet janë të pranueshme dhe ato do të rishikohen në përputhje me rrethanat. AKSHI do të facilitojë takimet me listën e synuar të të intervistuarve për statusin aktual të sigurisë kibernetike dhe mbledhjen e dokumenteve të nevojshme për raportin e vlerësimit fillestar. Konsulenti do të kryejë misione në terren për të siguruar përfundimin me sukses të detyrës (parashikohen të paktën 5 misione). Konsulenti pritët të kontribuojë me një raport të shkurtër që përmbledh aktivitetet dhe rezultatet kryesore në fund të çdo misioni.

Për çështje administrative, konsulenti do të komunikojë me NJK-në rast pas rasti.

## **6. KUSHTET**

Detyra pritët të fillojë në Gusht 2024. Niveli i angazhimit është maksimumi 100 ditë pune i shpërndarë në 18 muaj, me mundësi zgjatjeje të kontratës përtej vitit të parë, sipas nevojës. Nga 100 ditët e angazhimit, të paktën 50 ditë pune do të jenë fizikisht në ambientet e AKSHI-t.

Konsulenti nuk kërkohet të jetë i vendosur në Shqipëri, megjithëse ai/ajo pritët të vizitojë vendin sipas nevojës. Koha dhe shpeshtësia e vizitave do të dakordësohen paraprakisht me CU. Ndërmjet misioneve, Konsulenti duhet të jetë i disponueshëm për takime virtuale bazuar në orarin e rënë dakord me NJK.

## **7. KUALIFIKIMET E KONSULENTIT**

Konsulenti i angazhuar për projektin duhet të ketë një perspektivë ndërkombëtare për sigurinë kibernetike, incidentet kibernetike dhe menaxhimin e krizave (pra me një kuptim të mprehtë në kërcënimet kibernetike, por edhe me një këndvështrim strategjik, i fokusuar në mbrojtjen e sistemeve/shërbimeve qeveritare) dhe duhet të ketë ekspertizën dhe përvojën e mëposhtme:

- Të paktën diplomë master në drejtësi, shkenca politike, marrëdhënie ndërkombëtare, teknologji informacioni dhe sigurie kibernetike ose një kombinim ekuivalent i kualifikimeve akademike dhe përvojë pune në fushën e sigurisë kibernetike;
- Përvoja të mëparshme në rolin e ekspertit ndërkombëtar të sigurisë kibernetike me fokus në analizën e politikave, diplomacinë kibernetike dhe rritjen e kapaciteteve kibernetike. Të paktën dhjetë vjet përvojë profesionale në sigurinë kibernetike, me ekspertizë ndërkombëtare në kërkimin dhe analizën e politikave, menaxhimin e krizave kibernetike, qëndrueshmërinë kibernetike dhe diplomacinë kibernetike.

- Të paktën 3 vjet përvojë në përputhshmërinë me rregulloret dhe direktivat e BE-së për sigurinë kibernetike dhe sigurinë e informacionit;
- Përvojë e demonstruar në kryerjen e vlerësimeve të sigurisë kibernetike, duke marrë në analizë edhe përputhshmërinë me BE-në.
- Përvojë e dëshmuar dhe ekspertizë mbi rreziqet digjitale dhe qëndrueshmërinë kibernetike për të mbështetur përmirësimin e kuadrit rregullator kombëtar.
- Përvojë me teknologji dhe produkte të ndryshme sigurie, p.sh. Siguria e resë kompjuterike e Microsoft Azure konsiderohet një avantazh;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi me gojë dhe me shkrim në gjuhën angleze.

## **8. ZBATIMI DHE RREGULLIMET ORGANIZATIVE**

Konsulenti do të punojë në bashkëpunim të ngushtë dhe nën mbikëqyrjen e AKSHI dhe Njesisë së Koordinimit të Programit (CU). Për çështjet administrative konsulenti do të komunikojë sipas nevojës me CU, e përgjegjshme për zbatimin e aspekteve fiduciar të implementimit të projektit (Prokurim, Kontratë dhe Menaxhim Financiar). AKSHI do të sigurojë konsulentit facilitete, hapësirë zyre, dhe mjetet e komunikimit, sipas nevojës për performances së detyrës. Takimet pritete të mbahen edhe në ambiente të jashtme.

NJK do t'i ofrojë Konsulentit asistencë administrative, hapësirë për takime në mënyrë që të kryejë funksionet dhe përgjegjësitë e saj/tij gjatë misionëve të saj/saj. NJK do të ofrojë gjithashtu akses në internet, materiale dhe artikuj të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve kontraktuale. Konsulenti pritete të jetë i pajisur me kompjuterin/laptopin e saj/të tij personal.

## **9. KRITERET E VLERËSIMIT**

Aplikantët që plotësojnë kërkesat e kualifikimit do të vlerësohen më tej bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Përvoja e përgjithshme vjetore - 30 pikë
- Përvoja dhe aftësitë e përshtatshme për detyrën – 60 pikë
- Gjuha – 10 pikë

## **10. PËRZGJEDHJA**

Shërbimi do të zgjidhet sipas dispozitave të Rregullores së Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit nën Financimin e Projekteve të Investimeve” datë 1 korrik 2016, rishikuar në nëntor 2017, gusht 2018, nëntor 2020 bazuar në metodën e përzgjedhjes së konsulentëve individualë, kontratë e bazuar në kohë.